KËRKESË PËR SHQYRTIM

të një regjimi të diferencuar të akcizës dhe procedurave për nano- dhe mikrobirraritë shqiptare

në kuadër të Paketës Fiskale dhe Buxhetit të Shtetit

Drejtuar	Komisionit për Ekonominë, Punësimin dhe Financat, Kuvendi i Shqipërisë
Për dijeni	Ministrisë së Financave; Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit; Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave
Paraqitur nga	[Shoqata / Grupi i prodhuesve të birrës artizanale]
Objekti	Shqyrtimi i përjashtimit, reduktimit ose kompensimit të barrës së akcizës dhe i lehtësive procedurale për prodhuesit e vegjël të pavarur

I nderuar Komision,

Kjo parashtresë nuk synon të vendosë prodhuesit e vegjël të birrës mbi kategori të tjera të biznesit. Ajo kërkon që, gjatë shqyrtimit të Paketës Fiskale dhe Buxhetit të Shtetit, të vlerësohet në mënyrë të matshme nëse barra e akcizës dhe sistemi administrativ që e shoqëron janë proporcionalë me madhësinë, riskun dhe kontributin fiskal të nano- dhe mikrobirrarive shqiptare.

Pse prodhimi vendas dhe birra artizanale kanë rëndësi

Prodhimi vendas krijon vlerë brenda ekonomisë në disa hallka njëkohësisht: investim në pajisje dhe ambiente, punësim të drejtpërdrejtë, paga dhe sigurime, shërbime transporti e distribucioni, marketing, bare e restorante, furnitorë lokalë dhe të ardhura tatimore. Një produkt i importuar gjeneron aktivitet tregtar në Shqipëri, por një pjesë e ndjeshme e vlerës së prodhimit është krijuar jashtë vendit dhe si rrjedhojë dhe një pjesë e mirë e të ardhurave dalin jashtë vendit.

Për një vend me deficit të lartë tregtar dhe me një ekonomi turistike në rritje, produktet vendase të diferencuara kanë edhe një funksion tjetër: zëvendësojnë një pjesë të importeve dhe krijojnë produkte që mund të konsumohen si pjesë e përvojës shqiptare. Një mikrobirrari nuk është vetëm një linjë prodhimi; ajo mund të jetë një pikë gastronomike, një destinacion vizite, një klient për bujqësinë dhe shërbimet lokale dhe, nëse rritet, një markë e eksportueshme.


Birra artizanale është gjithashtu një sektor ku inovacioni ndodh në shkallë të vogël: receta të reja, përdorim i frutave, mjaltit, bimëve dhe drithërave lokale, bashkëpunime me prodhues të tjerë dhe krijim i kulturës së konsumit të produkteve me identitet. Për këtë arsye shumë juridiksione e trajtojnë prodhuesin e vogël të pavarur si kategori të veçantë në politikat e akcizës dhe procedurave.

Tregu shqiptar: humbje e pjesës së prodhimit vendas


Të dhënat tregojnë një ndryshim të qartë të strukturës së tregut.

Birra vendase vijon të shënojë rënie, ndërsa birra e importit shënoi nivelin më të lartë për dekadën e fundit (periudha e analizuar janar-shtator vitet 2016-2026), duke zgjeruar ndjeshëm peshën e saj në treg.

Në total për periudhën janar-shtator 2026 u prodhua një sasi prej 31,9 mln litra, sipas të dhënave zyrtare. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës prodhimi ra me 5%. Për prodhuesit e birrave rritja e kostos nga akciza mbetet e papërballueshme. Veçanërisht, prodhuesit vendas të mikrobirrarive ngrenë shqetësimin se kostoja e taksës po tejkalon shpenzimet për lëndën e parë.




Krahas tkurrjes së totalit të prodhimit vendas, importet e birrës vijojnë rritjen. Sipas të dhënave të doganave , importet e birrës gjatë periudhës janar–shtator 2026 arritën në sasinë e 46,6 mln litra. Importet u rritën me 3% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025. Rritja më e dukshme e importeve ka nisur pas vitit 2022, ndërsa niveli i vitit 2026 është ndër më të lartët për dekadën e fundit.



Por krahas rënies së prodhimit në treg po shtohet prezenca e birrës së huaj.

Për muajt janar-shtator 2026, sipas të dhënave të Doganave, pesha e birrës së importit arriti në 59%, kundrejt peshës prej 58% që pati në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ndërsa pesha e prodhimit vendas zbriti në 41% për muajt janar-shtator 2026 nga 42% që arriti për të njëjtën periudhës të vitit të mëparshëm.

Rritja e peshës së birrës së importit është më e dukshme pas vitit 2022, me hyrjen në fuqi nga 1 janari 2023 të dyfishimit të nivelit të akcizës.



Më tej, sipas të dhënave të publikuara nga Revista Monitor mbi bazën e Doganave dhe prodhimit vendas, në vitin 2019 prodhimi vendas përbënte rreth 51% të konsumit të birrës dhe importet 49%. Në databazën e sektorit për vitin 2024, prodhimi vendas rezulton rreth 34.76 milionë litra dhe importet rreth 56.69 milionë litra: afërsisht 38% prodhim vendas dhe 62% import. Për periudhën janar–nëntor 2025 raporti u përmirësua pjesërisht në rreth 42% vendas / 58% import, por prodhimi vendas mbetet ende dukshëm nën peshën që kishte në 2019.

Treguesi	2019	2024	2025 (janar–nëntor)
Pesha e prodhimit vendas	51%	rreth 38%	42%
Pesha e importeve	49%	rreth 62%	58%
Burimi	Monitor / Doganat	Databaza e sektorit 2024	Monitor / Doganat

Nga 2019 në 2024, pesha e prodhimit vendas në treg u ul me rreth 13 pikë përqindjeje. Kjo është një çështje e konkurrueshmërisë së prodhimit vendas, jo thjesht e konsumit total të birrës.

Mikrobirraritë: rënie e numrit dhe e volumit

Sipas të dhënave historike të sektorit, në vitin 2019 operonin 11 mikrobirrari me prodhim nën 500,000 litra/vit, me prodhim të përbashkët rreth 740,000 litra. Në vitin 2024 databaza e sektorit evidenton 9 prodhues të vegjël/artizanalë me vetëm 274,762 litra së bashku. Kjo nënkupton një rënie të volumit të këtij grupi prej rreth 63% në pesë vjet. Sipas vlerësimit aktual të Shoqatës (shtator 2026), numri i mikrobirrarive aktive është reduktuar më tej në rreth 5–6 subjekte.

Treguesi	2019	2024	Shtator 2026
Mikrobirrari aktive (të dhëna sektori)	11	9	rreth 5–6
Prodhim i përbashkët	rreth 740,000 L	274,762 L	në verifikim
Ndryshimi i volumit 2019–2024		-62.9%	

Mbyllja ose tkurrja e një mikrobirrarie nuk përfaqëson vetëm humbjen e një subjekti. Ajo nënkupton humbje të një investimi prodhues, të një blerësi për furnitorët vendas, të vendeve të punës dhe aftësive teknike, të një taksapaguesi dhe të një produkti potencial për gastronominë dhe turizmin. Nuk pretendohet se akciza është

shkaku i vetëm i këtyre mbylljeve; kostot e lëndëve të para, energjisë, financimit dhe konkurrenca kanë rol. Megjithatë, pesha e politikës së akcizës nuk mund të injorohet.

Në këtë pikë është veçanërisht i rëndësishëm konstatimi i vetë Administratës Doganore. Në "Librin Jeshil 2023 dhe Prioritetet 2024", Doganat raportojnë se, pavarësisht rritjes së të ardhurave nga akciza e birrës pas heqjes së diferencimit, sasia ra dhe "efektet më të mëdha në rënien e sasisë i kanë dhënë prodhimet vendase, të cilat më parë përfitonin nga niveli i diferencuar i akcizës si prodhues të vegjël". Ky konstatim zyrtar e bën të arsyeshëm një rivlerësim të efektit afatmesëm të politikës mbi prodhimin vendas.

Krahasimi ndërkombëtar: një sektor i vogël, por i njohur si kategori më vete

Nuk do të ishte e saktë të thuhej se craft beer është rritur pa ndërprerje "kudo në botë". Në vitet e fundit disa tregje të pjekura kanë hyrë në fazë stabilizimi ose tkurrjeje. Por periudha që parapriu dhe shoqëroi vitet 2019–2024 karakterizohet nga një zgjerim shumë i madh i numrit të prodhuesve të vegjël dhe nga njohja e tyre si segment i veçantë ekonomik.

Tregu / treguesi	2019	Viti krahasues	Ndryshimi / konteksti
SHBA – craft breëeries	8,419	9,796 në 2024	+16.4% në numër; tregu u maturua dhe volumi ra në 2024
Francë – mikrobirrari	1,650	2,300 në 2021	rritje e fortë; në 2024 Franca raportonte rreth 2,500 birrari, 1,800 prodhues të pavarur
Itali – mikrobirrari	684	814 në 2021	rritje në fillim të periudhës; Italia mban regjim ligjor/fiskal të posaçëm për mikrobirraritë
BE – industria e birrës	mbi 10,000 birrari në 2019	rreth 10,000 në 2024	sektor i konsoliduar; mbi 2 milionë vende pune në zinxhirin e vlerës sipas Breëers of Europe

Krahasimi tregon një kontrast të rëndësishëm: ndërsa shumë tregje europiane dhe amerikane ndërtuan mijëra prodhues të vegjël dhe më pas u përballën me sfidat e një tregu të pjekur, Shqipëria po sheh tkurrje të një sektori që ende nuk ka arritur as fazën e konsolidimit. Kjo është arsyeja pse vlerësimi i barrës fiskale dhe administrative duhet të marrë parasysh fazën e zhvillimit të tregut shqiptar.

Pesha fiskale e sektorit të vogël

Nëntë prodhuesit e vegjël/artizanalë të evidentuar në vitin 2024 kanë prodhuar vetëm 274,762 litra, rreth 0.79% të prodhimit vendas dhe 0.30% të volumit total të tregut të evidentuar. Me normën aktuale prej 744.4 lekë/HL për çdo shkallë alkoolometrike, barra teorike e akcizës për këtë volum është rreth 8.18 milionë lekë në një gradacion mesatar 4% ABV dhe 10.23 milionë lekë në 5% ABV. Këto janë vlerësime teorike dhe duhet të zëvendësohen me të dhënat reale të Doganave gjatë vlerësimit fiskal.

Çështja që shtrohet për Komisionin nuk është nëse 8–10 milionë lekë janë ose jo të ardhura publike. Çështja është nëse mbledhja e kësaj shume, së bashku me kostot e administrimit dhe përputhshmërisë që kërkon sistemi i akcizës, prodhon më shumë vlerë publike sesa një regjim që i lë prodhuesit e vegjël më shumë hapësirë për investim, formalizim, punësim, inovacion dhe rritje të bazës së ardhshme tatimore.

Barra kumulative e një prodhuesi të vogël

Përveç akcizës, një mikrobirrari e formalizuar përballon detyrimet e zakonshme të një ndërmarrjeje prodhuese: TVSH dhe administrimin e saj, tatimet mbi fitimin sipas regjimit përkatës, paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore, taksa vendore dhe të pronës, kërkesa të sigurisë ushqimore, kolaudim/kalibrim të pajisjeve matëse, detyrime mjedisore dhe procedura të magazinës fiskale. Disa prej këtyre detyrimeve janë të domosdoshme dhe nuk kërkohet heqja e standardeve të sigurisë. Problemi i ngritur nga sektori është që kostot fikse të përputhshmërisë bien shumë më rëndë mbi një biznes që prodhon dhjetëra mijëra litra sesa mbi një fabrikë që prodhon miliona litra.

Kërkesat për shqyrtim

Masa	Përmbajtja
1. Kategoritë	Të njihen nano-birraritë deri në 100,000 L/vit, mikrobirraritë 100,001–500,000 L/vit, birraritë e mesme 500,001–2,000,000 L/vit dhe prodhimi i madh/industrial mbi 2,000,000 L/vit.
2. Akciza	Të analizohet përjashtimi nga akciza për prodhuesit deri në 500,000 L/vit. Nëse harmonizimi me acquis-in nuk e lejon përjashtimin e plotë, të shqyrtohet reduktimi maksimal i lejuar dhe/ose instrument mbështetës ekuivalent, i pajtueshëm me rregullat e ndihmës shtetërore.
3. R&D	Birra e përdorur për prova prodhimi, analiza dhe kërkim-zhvillim, kur nuk hidhet në treg, të ketë përjashtim ose trajtim të posaçëm me dokumentim të thjeshtuar.
4. Firo teknologjike	Për nano- dhe mikrobirraritë, 10% të shërbejë si prag administrativ orientues për vetëregjistrim të thjeshtuar, jo si tavan; humbjet më të larta të njihen kur justifikohen teknikisht.
5. Procedurat	Deklarime të konsoliduara, dokumentim elektronik, kontrolle sipas riskut, procedura të thjeshtuara për inventarë/asgjësim dhe rishikim të garancive e kostove fikse administrative.
6. Rishikimi	Masa të pilotohet për 2–3 vite dhe të rivlerësohet me tregues të matshëm: numër prodhuesish, punësim, investime, TVSH/tatime/sigurime, prodhim vendas, importe, eksporte dhe produkte të reja.

Kjo parashtresë shoqërohet me Aneksin Teknik më poshtë.

ANEKS TEKNIK

Të dhëna, krahasime dhe arsyetim ekonomik për shqyrtimin parlamentar

1. Të dhënat e prodhuesve të vegjël – 2024

Prodhuesi	Prodhimi i deklaruar 2024
BEGEJA 1900 H.T.P-SHPK	100,390 L
PAN'S MICROBREËERY - SHPK	39,050.5 L
ELMIRA TUSHA - PERSON FIZIK	37,020 L
ALFRED SHASKA - PERSON FIZIK	29,640 L
MARIO XHUMARI - PERSON FIZIK	26,000 L
JEZZ - SHPK	17,508.15 L
KOSTANA - SHPK	15,557.35 L
ALKETA XEGA - PERSON FIZIK	8,000 L
REFAIL ÇIKOPANO - PERSON FIZIK	1,596 L
TOTAL	274,762 L

Burimi: databaza 2024 e vënë në dispozicion nga përfaqësuesit e sektorit. Totali i prodhimit vendas në të njëjtën databazë: 34,757,401 L; importe: 56,691,798 L; volum total i evidentuar: 91,449,200 L.

2. Diferencimi fiskal ekziston tashmë për verën

Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, birra tatohet me 744.4 lekë/HL për çdo shkallë alkoolometrike, pa diferencim sipas madhësisë së prodhuesit. Ndërkohë, për verën e qetë sistemi parashikon norma të ndryshme sipas prodhimit vjetor: një prodhues nën 10,000 HL paguan 31.455 lekë/litër për verë deri në 12.5% alkool, ndërsa një prodhues mbi 10,000 HL paguan 104.85 lekë/litër.

Ky krahasim nuk provon vetvetiu se një normë e caktuar për birrën është e padrejtë. Ai tregon se parimi i diferencimit sipas shkallës së prodhuesit ekziston tashmë në sistemin shqiptar të akcizës dhe mund të analizohet edhe për birrën.

3. Praktika e BE-së dhe opsionet juridike

Direktiva 92/83/KEE, neni 4, lejon norma të reduktuara për birrën e prodhuar nga birrari të vogla të pavarura, të diferencuara sipas prodhimit vjetor. Lehtësia mund të zbatohet deri në 200,000 HL/vit dhe norma e reduktuar nuk mund të jetë më shumë se 50% nën normën standarde kombëtare.

Italia zbaton aktualisht një reduktim prej 40% për microbirrifici që plotësojnë kriteret e pavarësisë dhe prodhojnë jo më shumë se 10,000 HL/vit. Kjo tregon se trajtimi i diferencuar i prodhuesit të vogël është praktikë e përdorur brenda BE-së.

Përjashtimi i plotë nga akciza për birrën komerciale duhet t'i nënshtrohet analizës juridike në kuadër të përafrimit me acquis-in. Për këtë arsye kërkesa e sektorit paraqitet së bashku me alternativën e reduktimit maksimal dhe/ose skemave kompensuese të pajtueshme me rregullat e ndihmës shtetërore.

4. R&D dhe firot teknologjike

Direktiva 92/83/KEE u lejon shteteve të përjashtojnë produktet e mbuluara nga akciza kur përdoren si mostra për analiza, prova të nevojshme prodhimi ose kërkim shkencor, me masa kundër abuzimit.

Për nano- dhe mikrobirraritë propozohet regjim i thjeshtuar për batch-et eksperimentale që nuk shiten: regjistrim elektronik i recetës, sasisë dhe destinacionit, pa trajtim si produkt i hedhur në konsum.

Për humbjet teknologjike propozohet 10% si prag administrativ orientues për vetëregjistrim, jo si kufi maksimal. Humbjet mbi këtë nivel të njihen kur dokumentohen sipas stilit dhe procesit (dry hopping, fruta, sedimente, transferime, paketim etj.). Mungesat e inventarit pa shpjegim teknik të trajtohen sipas rregullave normale të akcizës.

5. Bilanci tregtar dhe konteksti i prodhimit vendas

Të dhënat e INSTAT tregojnë dobësim të raportit të mbulimit të importeve me eksporte gjatë viteve të fundit. Sektori i birrës është shumë i vogël për të ndryshuar vetë bilancin tregtar kombëtar, por tendenca është kontekst i arsyeshëm për politika që nxisin prodhim të tregtueshëm vendas, zëvendësim importesh dhe kapacitete eksportuese.

Viti	Eksporte (mld lekë)	Importe (mld lekë)	Bilanci (mld lekë)	Mbulimi
2021	367	784	-423	46.0%
2022	481	950	-464	51.2%
2023	430	873	-432	50.5%
2024	369	894	-526	41.2%
2025	346	887	-541	39.0%

Nga 2022 në 2025 eksportet ranë nga rreth 481 në 346 miliardë lekë, ndërsa raporti i mbulimit të importeve me eksporte ra nga 51.2% në 39.0%. Kjo nuk është argument për proteksionizëm; është arsye për të analizuar konkurrueshmërinë e prodhimit vendas dhe aftësinë e tij për të krijuar vlerë të tregtueshme.

6. Turizmi, gastronomia dhe komuniteti

INSTAT regjistroi 12.47 milionë hyrje të shtetasve të huaj në Shqipëri gjatë vitit 2025, rreth 6.6% më shumë se në vitin 2024. Në një ekonomi me flukse të mëdha turistike, oferta e produkteve lokale është pjesë e diferencimit gastronomik të destinacionit.

- produkte dhe shije që lidhen me vendin dhe nuk gjenden njësoj në tregjet e tjera;
- lidhje me bare, restorante, festivale dhe vizita në punishte;
- mundësi për përdorim të frutave, mjaltit, bimëve dhe përbërësve lokalë;
- krijim aftësish teknike dhe sipërmarrjesh të reja;
- marka shqiptare që mund të kalojnë gradualisht nga tregu vendas në eksport;
- komunitete lokale rreth taproom-eve, breëpub-eve dhe aktiviteteve gastronomike.

7. Treguesit për një skemë pilot

- numri i prodhuesve aktivë dhe i vendeve të punës;
- investimet në impiante, laboratorë dhe paketim;
- TVSH, tatim-fitimi, paga dhe sigurime të paguara nga subjektet përfituese;
- volumi i prodhimit vendas kundrejt importeve;
- numri dhe vlera e eksporteve;
- produktet e reja/R&D dhe përdorimi i lëndëve të para lokale;
- vizitat në punishte dhe aktivitetet e turizmit gastronomik.

Një klauzolë rishikimi pas 2–3 vjetësh do të lejonte që masa të vazhdojë, ndryshojë ose përfundojë mbi bazën e rezultateve reale.

8. Përfundim

Sektori nuk kërkon ulje të standardeve të sigurisë ushqimore dhe as përjashtim nga detyrimet e përgjithshme të një biznesi të formalizuar. Kërkesa është që prodhuesit shumë të vegjël të mos trajtohen fiskalisht dhe administrativisht sikur të kishin të njëjtën strukturë dhe kapacitet me një fabrikë industriale.

Në vitin 2024 grupi i nëntë prodhuesve të vegjël/artizanalë përfaqësonte vetëm rreth 0.30% të volumit të tregut të evidentuar. Në të njëjtën kohë, numri dhe volumi i mikrobirrarive kanë rënë ndjeshëm krahasuar me 2019 dhe pjesa e prodhimit vendas në treg është tkurrur. Këto të dhëna justifikojnë, të paktën, një analizë të plotë kosto–përfitim të regjimit aktual dhe testimin e një modeli proporcional për prodhuesit e vegjël të pavarur.

Përfaqësuesi: _____ **Shoqata / Organizata:** _____

Data: _____

9. Burimet kryesore

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, “Libri Jeshil 2023 dhe Prioritetet 2024”, sektori i pijeve alkoolike: konstatimi mbi rënien e sasisë së birrës dhe efektin më të madh te prodhimet vendase pas heqjes së diferencimit. https://ëëë.dogana.gov.al/dokument/5179/libri-jeshil-2023-prioritete-2024.pdf

2. Revista Monitor, “Pijet alkoolike nuk po ‘dehin’...”, të dhëna mbi strukturën prodhim vendas/import në 2019 dhe janar–nëntor 2025. https://monitor.al/pijet-alkoolike-nuk-po-dehin-ashtu-si-ne-bote-dhe-te-rinjte-shqiptare-nuk-po-pine-me/

3. Databaza e sektorit për vitin 2024 (e vënë në dispozicion nga përfaqësuesit): prodhim vendas 34.757 mln L, importe 56.692 mln L, 9 prodhues të vegjël/artizanalë 274,762 L.

4. Brewers Association, National Beer Sales & Production Data dhe 2024 U.S. Craft Brewing Industry Figures: 8,419 craft breweries në 2019 dhe 9,796 në 2024; prodhimi craft -3.9% në 2024. https://ëëë.breëersassociation.org/statistics-and-data/national-beer-stats/

5. The Brewers of Europe, European Beer Trends 2020/2022: të dhëna historike për mikrobirraritë në Europë; France 1,650 (2019) → 2,300 (2021), Italy 684 → 814, etj. https://breëersofeurope.org/

6. Assemblée nationale / Ministère de l’Économie (Francë), 2024: rreth 2,500 birrari, prej tyre rreth 1,800 prodhues të pavarur. https://questions.assemblee-nationale.fr/q17/17-196QE.htm

7. The Brewers of Europe, Beer Manifesto 2024–2029: rreth 10,000 birrari dhe mbi 2 milionë vende pune në zinxhirin e birrës në BE. https://www.brewersofeurope.org/beer-manifesto/

8. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Llogaritja e Akcizës – norma e birrës dhe normat e diferencuara të verës. https://ëëë.dogana.gov.al/c/183/330/llogaritja-e-akcizes

9. Council Directive 92/83/EEC – neni 4 për birraritë e vogla të pavarura dhe neni 27(2) për analiza/prova/kërkim. https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:31992L0083

10. INSTAT, Foreign Trade in Goods 2021–2025 dhe Movements of Citizens 2025. https://ëëë.instat.gov.al/

Shënim metodologjik: Të dhënat 2019 për numrin dhe volumin e mikrobirrarive janë të dhëna historike të paraqitura nga sektori dhe duhet të verifikohen me Doganat/QKB përpara depozitimit final. Vlerësimi 5–6 mikrobirrari aktive në shtator 2026 është vlerësim i Shoqatës. Shifrat 8.18–10.23 milionë lekë janë llogaritje teorike, jo të dhëna të akcizës së paguar.